

URDHËR
Nr. 160, datë 26.7.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E ORGANIT TË NDËRMJETËM PËR MENAXHIMIN E
POLITIKAVE (ONMP), TË DREJTUESIT DHE PËRGJEGJËSISË SË NËNSHKRIMIT
PËR ZBATIMIN PËRMES MENAXHIMIT INDIREKT TË PROGRAMIT VJETOR IPA
III, NË LIDHJE ME AKTIVITETIN PËR KONEKTIVITETIN
DIGJITAL/*BROADBAND*-IN**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian, për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të Bashkimit Evropian për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III), ratifikuar me ligjin nr. 65/2022; të nenit 28, pika 2, të Kodit të Procedurave Administrative; si dhe në përputhje me vendimin nr. 540, datë 20.9.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësiave dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III)”,

URDHËROJ:

1. Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave, në Drejtorinë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Infrastrukturës dhe Territorit, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, caktohet për të përmbushur përgjegjësitë e Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin e Politikave (ONMP), për zbatimin përmes menaxhimit indirekt të veprimit të BE për Shqipërinë për vitin 2022, në lidhje me aktivitetin për konektivitetin digjital/*broadband*-in, të financuar nga BE-ja në kuadër të IPA III, në përputhje me parashikimet e FFPA-së dhe kuadrin ligjor për IPA III.

2. Znj. Irena Malolli, si drejtuese e Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacionit dhe Postave, drejton ONMP-në dhe autorizohet të nënshkruajë dokumentet e mëposhtme:

a) Marrëveshje mbi bashkëpunimin ndërinstitucional ndërmjet Koordinatorit Kombëtar të IPA-s, Zyrtarit Kombëtar të Autorizimit, Autoritetit Menaxhues, Organeve të Ndërmjetme për Menaxhimin e Politikave dhe Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin Financiar për zbatimin përmes menaxhimit indirekt të veprimit të “BE për Shqipërinë” për vitin 2022, në lidhje me aktivitetin për konektivitetin digjital/*broadband*-in, të financuar nga BE-ja në kuadër të IPA III;

b) Rregulloret dhe udhëzuesit procedurale të IPA III, për organet e ndërmjetme për menaxhimin e politikave;

c) Çdo raport, dokument apo komunikim tjetër lidhur me zbatimin e veprimit “BE për Shqipërinë” të mbajtur me Koordinatorin Kombëtar të IPA-s, Zyrtarin Kombëtar Autorizues, Autoritetin Menaxhues, Autoritetin Auditues, organit kontabël, Zyrës Mbështetëse të ZKA-së, organin e ndërmjetëm për menaxhimin financiar dhe çdo komunikim tjetër të lidhur me përgjegjësitë funksionale të ONMP-ve të parashikuara në FFPA dhe VKM-në nr. 540, datë 20.9.2023.

3. Urdhri nr. 46, datë 28.2.2024, “Për përcaktimin e Organit të Ndërmjetëm për Menaxhimin e Politikave (ONMP), të drejtuesit dhe përgjegjësisë së nënshkrimit për zbatimin përmes menaxhimit indirekt të programit vjetor IPA III”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet znj. Irena Malolli dhe Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Zhvillimit të Telekomunikacioneve dhe Postave për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**